

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

"MARSI" sh.p.k

Sot, më datën 20.05.1995, unë inëshkruari Ylber Elezi, i biri i Nebiut i datëlindjes 1963, lindur dhe banues në Kukës, i deklaruar ortak i vetëm vendosa si më poshtë:

Neni 1

Të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "MARSI" sh.p.k.

Neni 2

Selia e shoqërisë është në lagjen (zona industriale), por ajo mund të hapë vendqëndrim të tjera të dyta, filiale, përfaqësi, agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë shtetit.

Neni 3

Kapitali themeltar i shoqërisë është; 100.000 lekë.

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi 10 vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

Neni 5

Shoqëria ka objekt veprimtarie: Prodhimin, përpunimin e punimeve të drurit e tregëtimit të mallrave me shumicë e pakicë e veprimtarinë e eksport-importit.

Neni 6

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas legjislacionit shqiptar mbi bazën e aktit të themelimit dhe të statutit të saj.

Neni 7

Administrator i shoqërisë është ortak i vetëm Ylber Elezi

Neni 8

Për kapitalin themeltar shoqëria ka librin e llogarive dhe gjithë dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit për kontabilitet

Neni 9

Mos marrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do të zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Neni 10

Akti i themelimit u përpilua në 4 (katër) kopje për tu depozituar sipas ligjit.

ORTAKU I VETËM

YLBER ELEZI



STATUTI
I SHOQËRISË "M A R S I" SH.P.K

Neni 1

Është krijuar shoqëria me Përgjegjësi të kufizuar "Marsi" SH.P.K me ortak të vetëm Z.Ylber Elezin, banues në qytetin e Kukësit.

Neni 2

Selia e Shoqërisë është në zonën industriale Kukës, Shoqëria mund të hapë edhe vendqëndrime të tjera të dyta operative, filiale, përfaqësi e agjensi në të gjithë teritorin e vendit.

KOHËZGJATJA

Neni 3

Kohëzgjatja e Veprimtarisë së Shoqërisë është mbi 10 vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Shoqëria ka objekt veprimtarie: Prodhimin, përpunimin e punimeve të drurit e tregëtimit e mallrave me shumicë e pakicë e veprimtarinë e eksport-importit.

Neni 5

Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë sipas vendimeve që do të marrë ortakët i vetëm.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind) mijë lekë i formuar në masë të plotë nga ortakët i vetëm Ylber Elezi.

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë mund të shtohet ose pakësohet sipas vendimeve që do të marrë ortakët i vetëm.

DREJTIMI E ADMINISTRIMI

Neni 7

Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj si person juridik në gjykatën e rrethit Tiranë dhe ushtron aktivitetin e saj tregëtar që nga regjistrimi në zyrën e Taksa Tatimeve.

Neni 8

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private, mer përsipër vetë të drejtat e detyrimit, përgjigjet për detyrimet e saj kontraktuale brënda kapitalit të saj.

Neni 9

Ortakët i vetëm Ylber Elezi mer vendim në zbatim të akteve ligjore e nënligjore që janë në fuqi, në zbatim të dispozitave të Statutit, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë të punësuarit në këtë Shoqëri.

Neni 10

Ortaku i vetëm cakton: financiar e punonjës të ndryshëm sipas nevojave të Veprimitarisë së Shoqërisë.

Neni 11

Ortaku i vetëm është i veshur me të gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshme e të jashtëzakonshme të shoqërisë, pa asnjë lloj kufizimi, kryen të gjitha aktet që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimit të Shoqërisë. Lidh kontrata me subjekte fizike e juridike, kryen çdo lloj veprimi pune pranë zyreve private e shtetërore, pranë organeve financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa e arkëtime.

Neni 12

Përfaqësimi i Shoqërisë i përket ortakut të vetëm në të gjitha organet administrative e gjyqësore se dhe mund të angazhojë avokat.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 13

Veprimet ekonomike e financiare të Shoqërisë mbylleen në 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe ushtrimore, administratori nxjerr Bilancin kontabël të shoqërisë me llogarinë fitim-humbje, mbështetur në ligje dhe rregulla të mbajtjes së kontabilitetit, nga subjektet tregëtare përcaktuar nga organet kompetente të sistemit fiskal. Bilanci kontabël miratohet nga ortaku i vetëm i cili vendos për krijimin e fondeve ligjore të ndryshme të nevojshme për zhvillimin e veprimitarisë ekonomike të shoqërisë si dhe për fondin e akumulimit e atë rezervë. Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve ligjore të përmendura më sipër dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale i mbesin për përdorim ortakut të vetëm.

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

Neni 14

Shpërndarja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë për çfarëdo shkak si humbje e kapitalit, pamundësi veprimitarie etj. Në këtë rast ortaku i vetëm vendos për mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë, këta bëjnë kujdes që shoqëria të likujdojë më parë detyrimet që ka ndaj të tretëve.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 15

Përsa nuk është shprehur në këtë Statut i referohet plotësisht me të bëra nga administratori i Shoqërisë si dhe legjislacionit shqiptar.

Neni 16

Ky Statut u hartua në 4 kopje për tu administruar sipas ligjit.

ORTAKU I VETËM

YLBER HLEZI

